

**MBI AKTIVITETIN
E KOMISIONIT TË POSAÇËM
PARLAMENTAR
DHE ZHVILLIMET NË REFORMËN
PËR MIRËQEVERISJEN, ANTIKORRUPSIONIN
DHE SUNDIMIN E LIGJIT**



**KPP – Buletin periodik 02
Korrik 2024**



**KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR
“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN
PËR SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**

Gjatë muajit korrik 2024, Komisioni i Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, antikorrupsionin dhe sundimin e ligjit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian” ka vijuar punën e tij përgatitore si dhe ka nisur fazën e parë për hartimin e dokumentit analitik (analizës), dokument i cili do të përgatitet nga Grupi i Ekspertëve, tashmë i krijuar dhe bërë funksional pranë këtij Komisioni.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar dhe ekspertët e Kuvendit pranë Sekretariatit Teknik kanë përgatitur koncept-idenë për strukturën orientuese të dokumentit analitik, sipas tri shtyllave kryesore: i) Mirëqeverisja, ii) Antikorrupsioni dhe iii) Sundimi i ligjit.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është punuar për krijimin e platformës së komunikimit publik dhe ndërtimit të faqes së internetit, dedikuar punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar, në mënyrë që i gjithë procesi të jetë sa më transparent dhe institucional, me përfshirjen e të gjithë aktorëve dhe faktorëve.

Përgjatë muajit korrik iu dërguan dhe u përpunuan përgjigjet e ftesave për bashkëpunim dhe angazhim **75** institucioneve dhe organizatave në vend, duke përfshirë **7** institucione të pavarura (institucione të krijuara nga Kuvendi dhe që raportojnë para tij); **22** organizatave të shoqërisë civile (bazuar në regjistrin e OJF-ve, të regjistruar në Kuvend); **9** universiteteve publike dhe jopublike (kryesisht ato me fakultete Drejtësie dhe të fakulteteve të Ekonomikut); **8** organizatave kryesore përfaqësuese të komunitetit të biznesit; **6** agjencive ekzekutive ligjzbatuese, **12** institucioneve të sistemit të drejtësisë si dhe **11** institucioneve të qeverisjes qendrore, kryesisht ato të konsideruara me risk të lartë korrupsioni nga BE-ja, me qëllim përfshirjen e tyre në këtë proces që në fazën fillestare.

Nga regjistri përkatës i administruar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar, rezulton se deri më 31 korrik numri i profesionistëve të propozuar për angazhim pranë Komisionit, në strukturat e ngritura prej tij, është afro **110 persona gjithsej**.

Tashmë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar funksionon Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL) dhe Sekretariatit Teknik (ST), i cili përbëhet nga rreth **70 ekspertë të propozuar** (*54 ekspertë të propozuar si pjesë e GENL-së dhe 16 si pjesë e ST-së*) nga institucionet e pavarura, shoqëria civile, pedagogë të fakulteteve të Drejtësisë dhe të Ekonomisë, të universiteteve publike e jopublike dhe organizatave të komunitetit të biznesit.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar në mbledhjet e tij ka vendosur të bëjë një ftesë publike për **ekspertizën ndërkombëtare** që dëshiron të përfshihet në këtë proces, duke kontribuar me dokumente të prodhuara prej tyre, me këshilla dhe ekspertizë si konsulentë të jashtëm e të tjerë.

Gjatë ditëve të fundit të muajit u janë dërguar ftesa mbi 50 organizatave ndërkombëtare, ekspertëve ndërkombëtarë, instituteve, fakulteteve e të tjera.

- Për të siguruar një pjesëmarrje sa më të gjerë në këtë proces të ekspertizës ndërkombëtare, Komisioni i Posaçëm Parlamentar, krahas publikimit në faqen e tij në *web*, u ka dërguar ftesë publike për bashkëpunim rreth 25 organizatave të njohura ndërkombëtare me seli në Shqipëri (14) dhe jashtë saj (11), si: Këshilli i Europës, OSBE, USAID, FATF, UNDP, Banka Botërore, SIDA, *Austrian Development Agency* e të tjera, të cilat i ka ftuar të bëhen pjesë e këtij procesi për ta asistuar dhe monitoruar atë, për kontribute konkrete në formën e dokumenteve (studime, raporte, analiza e të tjera), si dhe me këshilltarë të caktuar prej tyre si konsulentë të jashtëm pranë GENL-së. Ftesë për bashkëpunim u është dërguar dy misioneve të rëndësishme të asistencës ndërkombëtare në vendin tonë, si JUSTAL dhe OPDAT. Po ashtu, janë ftuar për ekspertizë tri institucione akademike, si: *College of Europe*, Universiteti i Shkencave Juridike të Salentos dhe Universiteti gjerman “Hertie School”.

Gjithashtu, ftesa u është dërguar edhe rreth **18 ekspertëve të huaj, shtetas të vendeve të ndryshme** (si ekspertë dhe pedagogë të universiteteve në SHBA, në Gjermani, në Itali, në Austri, në Kroaci, në Mbretërinë e Bashkuar e të tjerë), të cilët janë ekspertë të njohur ndërkombëtarisht dhe kanë pasur më parë bashkëpunime me institucionet shqiptare në fushat që lidhen me objektin e punës së këtij Komisioni të Posaçëm Parlamentar.

- Njëkohësisht, bazuar në vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, u është dërguar ftesë për përfshirje në këtë proces, në rolin e konsulentëve të jashtëm, edhe rreth **13 shtetasve shqiptarë** që jetojnë e punojnë jashtë vendit dhe kanë një përvojë të spikatur dhe të certifikuar ndërkombëtarisht si ekspertë apo pedagogë në universitete të huaja, si: në Holandë, në Gjermani, në Norvegji, në Mbretërinë e Bashkuar e të tjera.

Mbledhjet e Komisionit të Posaçëm Parlamentar

Gjatë muajit korrik 2024, Komisioni ka zhvilluar në total 3 mbledhje, gjatë të cilave janë marrë vendime të natyrës përgatitore e organizative, si vijon:

- **Mbledhja e tretë e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, e zhvilluar më 10 korrik 2024**, miratoi tri vendime, me përmbajtje si më poshtë vijon:

1. *T'u dërgojë kërkesë grupeve parlamentare të opozitës të regjistruara në Kuvend, për propozimin e përfaqësuesve/ekspertëve pranë 3 nëngrupeve të punës të ngritura në Komisionin e Posaçëm Parlamentar, si dhe në Sekretariatit Teknik.*

2. *T'u dërgojë ftesë për bashkëpunim të gjitha institucioneve, organeve dhe organizatave që veprojnë brenda sistemit të drejtësisë dhe ushtrojnë funksione në fushën e drejtësisë, për përfaqësimin me ekspertë/profesionistë pranë Grupit të Ekspertëve. Përfaqësuesit e këtyre institucioneve do të krijojnë një nëngrup të ekspertëve dhe do të angazhohen në hartimin e analizës për sundimin e ligjit*

në fushën e drejtësisë, në hartimin e planit përkatës të veprimit, si dhe do të sugjerojnë propozimet për ndryshime të mundshme ligjore dhe institucionale. Ftesa për bashkëpunim iu drejtua Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, SPAK-ut (Prokurorisë së Posaçme dhe BKH-së), Shkollës së Magjistraturës, Gjykatës së Lartë, Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

3. *Tu dërgohet ftesë publike për bashkëpunim organeve të medias audiovizive, medias së shkruar, medias online dhe asaj elektronike, të cilat kanë në fokus të angazhimit të tyre trajtimin e çështjeve që lidhen me 3 fushat kryesore objekt pune të komisionit, për shprehjen e interesit në përfshirje aktive në aktivitetin e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, si dhe pranë Grupit të Ekspertëve, për të ofruar kontributet e mundshme të tyre në këtë proces.*

▪ **Në datën 19.07.2024, Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi mbledhjen e tij të katërt, gjatë së cilës u prezantua dhe u miratua struktura orientuese e dokumentit analitik, sipas tri shtyllave kryesore: i) mirëqeverisja, ii) antikorrupsioni dhe iii) sundimi i ligjit, dhe më konkretisht:**

MIRËQEVERISJA

Analiza për shtyllën e parë, atë të mirëqeverisjes, do të ndërtohet mbi bazën e pesë komponentëve kryesorë, që lidhen me:

- *transparencën në reformën e administratës publike;*
- *efektshmërinë dhe integritetin e administratës publike;*
- *llogaridhënien e institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor;*
- *ofrimin e shërbimeve të digjitalizuara ndaj qytetarëve;*
- *efektivitetin dhe transparencën në menaxhimin e financave publike.*

ANTIKORRUPSIONI

Analiza për shtyllën e dytë, atë të antikorrupsionit, do të fokusohet në 5 komponentë kryesorë, që lidhen me:

- *parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit politik, për zyrtarët e lartë politikë, të zgjedhurit dhe vetë partitë politike;*
- *parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit në sektorët me risk më të lartë për korrupsion në qeverisjen qendrore dhe vendore, si dhe në tregun e lirë, konkurrueshmërinë dhe sektorin privat;*
- *funksionimin dhe eficiencën e institucioneve që luftojnë korrupsionin, konfliktin e interesit dhe abuzimin me financat publike;*
- *parandalimin e flukseve të paligjshme financiare dhe pastrimit të parave;*
- *ndërtimin e një shoqërie me integritet.*

SUNDIMI I LIGJIT

Analiza për shtyllën e tretë, atë të sundimit të ligjit, do të ndërtohet mbi tre komponentë kryesorë, që lidhen me:

- *funksionin ligjvënës, monitorues dhe koordinues të Kuvendit të Shqipërisë;*

- të drejtat dhe liritë themelore të njeriut;
- konsolidimin e Reformës në Drejtësi. (Analiza për këtë komponent, sipas metodologjisë së miratuar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar, do të kryhet së bashku me përfaqësuesit e vetë institucioneve të drejtësisë për fushën e përgjegjësisë që mbulojnë respektivisht, nën konsultimin, monitorimin dhe mbështetjen e misionëve të asistencës ndërkombëtare).

Korniza orientuese dhe burimet kryesore udhërrëfyese për dokumentin analitik do të jenë: kuadri ligjor dhe kushtetues në fuqi, por edhe rekomandimet dhe gjetjet kryesore të progresraportit dhe raportit *screening* për grupkapitujt e parë “Themeloret”, udhërrëfyesit e miratuar në dhjetor të vitit 2023, “Shteti i së drejtës” dhe “Reforma në administratën publike”, raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë, dokumentet strategjike dhe ndërsektoriale të miratuara nga qeveria shqiptare, angazhimet e qeverisë shqiptare në organizmat ndërkombëtarë, raportet e ndryshme të organizatave politike dhe ndërkombëtare, si: GRECO, MONEYVAL, DASH, OGP, *Transparency International*, OECD, SIGMA e të tjerë, si dhe raportet dhe analizat e shoqërisë civile dhe organizatave të tjera të biznesit.

- **Në datën 26.07.2024, Komisioni i Posaçëm Parlamentar zhvilloi mbledhjen e tij të pestë**, në të cilën u miratua projektvendimi “Për miratimin e përbërjes dhe drejtimit të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik”.

Më konkretisht, në vendim përcaktohet që Komisioni i Posaçëm:

1. Të administrojë dhe të miratojë regjistrin me emrat e propozuar të ekspertëve dhe Sekretariatit Teknik dhe të dhëna të tjera të sjella në përgjigje të ftesës për bashkëpunim nga subjektet e interesuara për t’u angazhuar dhe për të kontribuar në këtë proces.
2. Të administrojë dhe të miratojë listën e propozimeve për ekspertë në Grupin e Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe për Sekretariatit Teknik, bazuar në të dhënat e regjistrin të administruar si më sipër, në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Të miratojë përbërjen e nëngrupeve të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (nëngrupet e GENL-së), të organizuara sipas 3 fushave të objektit të veprimtarisë së këtij Komisioni, propozuar nga institucionet e pavarura, shoqëria civile, universitetet publike e jopublike dhe komuniteti i biznesit.
4. Të miratojë përbërjen dhe drejtimin e Sekretariatit Teknik, të cilët do të funksionojnë në mbështetje të nëngrupeve të GENL-së, të organizuar sipas 3 fushave të objektit të veprimtarisë së këtij Komisioni.
5. Të miratojë listën e ekspertëve dhe profesionistëve të propozuar nga institucionet shtetërore (agjencitë ekzekutive ligjzbatuese, institucionet me risk ndaj korrupsionit, ministritë dhe institucionet e tyre të varësisë), të cilët do të atashohen dhe do të përfshihen në këtë proces në mbështetje dhe sipas kërkesave të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë.

Zhvillohet takimi i parë i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik, që do të funksionojnë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”

Në datën 30 korrik u zhvillua takimi i parë i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë dhe Sekretariatit Teknik, që do të funksionojnë pranë Komisionit të Posaçëm Parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian”.

Në takimin e organizuar nga kryetari i Komisionit të Posaçëm, zoti Fatmir Xhafaj, morën pjesë rreth 60 ekspertë dhe përfaqësues të institucioneve të pavarura, të organizatave dhe të shoqërisë civile, të botës akademike, përfaqësues të komunitetit të biznesit e të tjerë, të cilët do të angazhohen për 3 fushat e objektit të veprimtarisë së këtij Komisioni.

Procesi është i qendërzuar dhe i mbështetur në kontributin dhe angazhimin e drejtpërdrejtë të ekspertëve për hartimin e:

- i. dokumentit analitik/analizës,*
- ii. Planit Kombëtar të Veprimit, bazuar mbi gjetjet e analizës, si dhe*
- iii. propozimin e zgjidhjeve dhe masave përkatëse legjislative e institucionale.*

Gjatë takimit, nga kryetari i Komisionit, zoti Xhafaj, u dha informacioni i detajuar lidhur me qëllimet, objektivat dhe metodologjinë që do të ndiqet për realizimin e fazës së parë të këtij procesi, ashtu si dhe iu përgjigj pyetjeve dhe sugjerimeve të ekspertëve të pranishëm.

Anëtarët e Komisionit, së bashku me stafin e Kuvendit, e pasuan këtë takim me takime të posaçme me ekspertët e të tria shtyllave, duke shpjeguar më në detaje metodologjinë dhe pritshmëritë për secilën shtyllë, si dhe orientuan e mbështetën në organizimin e tyre të brendshëm për procesin në vijim.

Çfarë pritet të ndodhë gjatë muajit gusht me agjendën e Komisionit?

I gjithë dokumentacioni i ardhur dhe i administruar nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar, i cili përbën kornizën kryesore të punës mbi të cilën do të ndërtohet dokumentit analitik/analiza, është vendosur në dispozicion të Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, të ndarë në 3 nëngrupe: i) Mirëqëverisja, ii) Antikorrupsioni dhe iii) Sundimi i ligjit.

Tashmë do të jenë ekspertët ata të cilët do të punojnë në mënyrë të pavarur dhe autonome në gjithë këtë proces, i cili në vazhdim do të monitorohet dhe asistohet edhe nga ekspertiza ndërkombëtare.

Gjatë muajit gusht grupet e ekspertëve do të angazhohen për njohjen, skanimin dhe analizën e dokumentacionit të vënë në dispozicion, duke identifikuar vlerësimet, gjetjet, problematikat dhe rekomandimet përkatëse për tri fushat objekt i punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar.

Komisioni i Posaçëm Parlamentar



KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

**“PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR MIRËQEVERISJEN,
SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN”**